



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 12.03.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për Këshilltarë dhe Ndhimës Ligjorë, që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:18 dhe mbaroi në orën 15:06.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*

RENDI I DITËS:

1. Miratimi i listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, që plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po zhvillojmë sot mbledhjen e radhës, siç e kishim parashikuar, të datës 12 mars 2019. Janë prezent të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë të Gjqësor.

Sikurse jeni vënë në dijeni, rendi i ditës sot ka 4 çështje.

Çështja e parë është: Miratimi i listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, për të marrë pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për vitin akademik 2019-2020. Çështja e dytë është: Miratimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.12, datë 18.01.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjqësor”. Çështja e tretë është: Miratimi i projektvendimit “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjqësor”. Dhe çështja e katërt është: Miratimi i

projektvendimit “Për deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm” lidhur me gjyqtarin {...}.

Atëherë, sipas rendit të ditës, kalojmë me çështjen...

Brunilda Kadi: Një sekondë, se kam unë një diskutim në lidhje me rendin e ditës. Kam unë një diskutim në lidhje me rendin e ditës.

Atëherë, dje jemi njoftuar nga drejtori juridik nëpërmjet e-mail-it për projektvendimin e kandidatëve. Ndërkohë, tek rendi i ditës thuhej edhe në lidhje me ndryshimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe ndërkohë nuk kishim asnjë material të përcjellë me e-mail.

Sot, në orën 10:00, na është sjellë në hard kopi (*hard copy*) projektvendimi, së bashku me nja dy shkresa, që ishte një relacion se si është reflektuar në lidhje me këtë strukturë të re që do duhet të riorganizohet pas vendimit të Kuvendit, një shkresë që i është dërguar DAP-it dhe nuk e di pse është nisur një kopje e procesverbalit të datës kur është miratuar.

Atëherë, unë kam një rezervë këtu dhe duhet të tërheq vëmendjen që, një gjë e tillë është haptazi në kundërshtim me ligjin. Jo vetëm që nuk është respektuar asnjëherë dispozita që thuhet ‘7 ditë përpara’ dhe të gjithë kemi rënë dakord për shkak të emergjencës kemi vepruar, por kjo nuk mund të bëhet rregull. Dhe ajo që e bën më të rëndë shkeljen është që çuditërisht, edhe herën e parë kur është miratuar struktura, nuk na ka ardhur, i vetmi material që nuk na ka ardhur asnjëherë më e-mail, ka qenë pikërisht vendimi i miratimit të strukturës dhe e njëjta gjë ndodhi edhe sot.

Tani, ka një problem procedural, ka edhe një problem tjetër teknik. Nëse ne na vijnë me hard kopi (*hard copy*) materialet, nuk ka asnjë mjet certifikimi se çfarë jemi duke vendosur dhe miratuar sepse siç e dini të gjithë, na ndodhi një diskutim, ditën që juve kryetare keni shkuar në Parlament dhe na rezultoi se asnjëri nga anëtarët e Këshillit nuk kishte kopjen e vendimit që ishte miratuar dhe që i kishte vajtur Kuvendit të Shqipërisë, sepse disa kishin një strukturë të miratuar me 145 persona, ndërkohë që ne pamë nga faqja e Kuvendit një strukturë të miratuar me 144 dhe vetëm nga kjo u nis diskutimi ‘hajde të shikojmë çfarë kemi miratuar’ dhe u konkludua dhe rezultoi që nuk ishte dërguar asnjëherë me e-mail ky vendim, ky projektvendim, kjo strukturë. E njëjta

gjë çuditërisht u përsërit edhe sot.

Unë konstatoj që materialet, përveç këtyre problemeve, nuk pasqyrojnë se si kjo strukturë i ka shkuar me këtë shkresë Departamentit të Administratës Publike. Kush e miratoi këtë sugjerimin që i çohet këtij departamenti? Nuk kemi një kthim përgjigje nga departamenti. Dhe gjithashtu, vërej edhe një mungesë të një dokumenti tjetër të rëndësishëm, në mbledhjen e datës, kur është miratuar herën e parë struktura, na është thënë nga juve Kryetare, në momentin përpara se të fillonte mbledhja, që nga ana e misionit EURALIUS është sjellë një mendim me shkrim por është sjellë në minutën e fundit. Pse nuk e kemi sot neve dhe pse nuk na është vënë asnjëherë në dispozicion ky material i EURALIUS-it, që të shikojmë çfarë kanë sugjeruar ata. I kemi gjithë kohës partnerë, si dhe misionin tjetër, unë mendoj që është domosdoshmëri që duhet ta kishim këtë material dhe nuk e kuptoj arsyen pse nuk është.

Kam edhe një diçka tjetër në lidhje me mbledhjet. Nga disa përfaqësues të mediave më është transmetuar shqetësimi që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka një mungesë të theksuar transparence, madje edhe profesionalizmi, sepse ndryshe nga organi tjetër dhe ndryshe nga organi që menduam se do sillnim revolucion, si nga ish-KLD-ja por edhe nga sot Këshilli i Lartë i Prokurorisë që nuk ka fare administratë, ndryshe nga ata që i kanë botuar dhe i kanë hedhur në internet procesverbalet audio, siç na detyron ligji, brenda 24 orëve, i kanë hedhur mbledhjet e tyre, ky Këshill nuk ka sot asnjë material audio në internet. Madje edhe procesverbalet e transkriptuara që, s'ka logjikë që ato duhet të hidhen më përpara se sa audio (sepse ligji thotë 1 muaj kanë afat) edhe ato janë hedhur me vonesë, por ato hidhen, audiot që duan 24 orë, nuk janë hedhur asnjëherë. Mendoj që këto janë probleme që duhet të diskutohen edhe nga anëtarët e tjerë. Gjithsesi unë prezantova shqetësimin tim. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, Bruna!

Atëherë, kalojmë me rendin e ditës?

Sipas rendit të ditës, çështja e parë që kemi për diskutim është: Miratimi i listës emërore të kandidatëve që plotësojnë kriteret për Këshilltarë dhe Ndihmës Ligjorë, që duhet të marrin pjesë në provimin e pranimit në programin e formimit fillestar për vitin akademik 2019-2020. Siç jeni në dijeni, Këshilli, me vendimin nr. 17, 29.01.2019,

miratoi numrin e kandidatëve që do pranohen në programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2019-2020. Në këtë vendim, Këshilli, përveçse caktoi numrin e kandidatëve për magistratë, për profilin gjyqtar, miratoi edhe numrin lidhur me pranimin e formimit fillestar edhe të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë. Gjithashtu, në këtë vendim, Këshilli përcaktoi edhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta ligjore që duhet të plotësojnë këto kandidatë për t'u pranuar në kryerjen e provimit fillestar. Për më tej, Këshilli, me vendimin nr. 18, 29.01.2019 ngriti edhe një Komision të përkohshëm “Mbi verifikimin e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për këshilltarë dhe ndihmës ligjorë...” që do pranoheshin për këtë vit akademik dhe në këtë vendim, gjithashtu është përcaktuar një afat që brenda datës 15 mars, Këshilli duhet të shqyrtojë propozimin e Komisionit.

Për më shumë detaje lidhur me projekt-aktin, po ia kaloj fjalën kryetarit të këtij Komisioni, zotit Erjon Muharremaj.

Erjon Muharremaj: Faleminderit!

Bazuar në nenet 34, 53, 55 dhe 56 të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 274 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Komisioni i Përkohshëm për Verifikimin e Plotësimit të Kriterëve të Kandidatëve për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë të përbërë nga unë, zonja Brunilda Kadi dhe zonja Brikena Ukperaj, u morën me verifikimin e plotësimit të kriterëve për kandidatët që kërkojnë të ndjekin formimin fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë, për vitin akademik 2019-2020, bazuar në dokumentacionin që na u përcoll nga Shkolla e Magjistraturës, që përmban të dhënat e çdo kandidati.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përfshirë në dosje, rezulton se për vitin akademik 2019-2020 kanë aplikuar për Këshilltarë dhe Ndhmës Ligjorë gjithsej 125 (njëqind e njëzetë e pesë) kandidatë, prej të cilëve 75 (shtatëdhjetë e pesë) kandidojnë edhe për magistratë njëkohësisht. Nga verifikimi rezulton se plotësojnë kriteret për Ndhmës Ligjorë 93 (nëntëdhjetë e tre) kandidatë, ndërsa nuk plotësojnë kriteret për Ndhmës Ligjorë 26 (njëzetë e gjashtë) kandidatë. Ndërsa për Këshilltarë Ligjorë plotësojnë kriteret 16 (gjashtëmbëdhjetë) kandidatë, ndërsa nuk plotësojnë kriteret 38

(tridhjetë e tetë) kandidatë.

Projektvendimit i bashkëlidhen edhe katër listat që janë pjesë përbërëse të tij, përkatësisht: 1. Lista e kandidatëve për Ndhmës Ligjorë që i plotësojnë dhe lista e dytë e kandidatëve që nuk i plotësojnë kriteret dhe; respektivisht edhe listat për Këshilltarë Ligjorë, lista e atyre që i plotësojnë kriteret dhe lista e kandidatëve që nuk plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit për Këshilltarë Ligjorë;

Skualifikimi i kandidatëve që nuk mund të marrin pjesë në provimin e pranimit për Ndhmës Ligjorë, është bazuar në mosplotësimin e kriterëve, si më poshtë vijon:

1. {...} - ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
2. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
3. {...}- ka notë mesatare nën 7 (shtatë) për grupin e lëndëve kryesore;
4. {...}- ka notë mesatare nën 7 (shtatë) për grupin e lëndëve kryesore;
5. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet, ka masë disiplinore dhe nuk ka master shkencor, por vetëm master profesional;
6. {...}- ka notë mesatare të përgjithshme nën 7 (shtatë) dhe notë mesatare për grupin e lëndëve kryesore nën 7 (shtatë);
7. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
8. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
9. {...}- ka notë mesatare nën 7 (shtatë) për grupin e lëndëve kryesore dhe përvojë profesionale që lidhet me gjykatën më pak se 3 vjet;
10. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
11. {...}- ka notë mesatare të përgjithshme nën 7 (shtatë) dhe notë mesatare për grupin e lëndëve kryesore nën 7 (shtatë);
12. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
13. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
14. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
15. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
16. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
17. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
18. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;

19. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
20. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
21. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
22. {...}- ka kryer studimet bachelor dhe master profesional, por jo master shkencor (siç është kriteri i përcaktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor);
23. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
24. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
25. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 5 vjet;
26. {...}- ka përvojë profesionale që lidhet me gjykatën më pak se 3 vjet.

Këto janë kandidatët që nuk plotësojnë kriteret për të marrë pjesë në provimin e pranimit për Ndhmës Ligjorë.

Ndërsa për Këshilltarët Ligjorë, në listën e atyre që nuk kualifikohen për të marrin pjesë në provimin e pranimit janë renditur:

1. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
2. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
3. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
4. {...}- nuk ka dokument që provon njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të Bashkimit Evropian;
5. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
6. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
7. {...}- ka notë mesatare të përgjithshme nën 7 (shtatë) dhe notë mesatare për grupin e lëndëve kryesore gjithashtu nën 7 (shtatë);
8. Age Domi - ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
9. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
10. {...}- ka notë mesatare nën shtatë për grupin e lëndëve kryesore;
11. {...}- nuk ka dokument që provon njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të Bashkimit Evropian;
12. {...} - ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet dhe nuk ka dokument që provon njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të Bashkimit Evropian;
13. {...} - ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;

14. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
15. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
16. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
17. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
18. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
19. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
20. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
21. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
22. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
23. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
24. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
25. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
26. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
27. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
28. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
29. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
30. {...} - ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
31. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
32. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
33. {...}- nuk ka dokument që provon njohuri shumë të mira të paktën të një gjuhe të Bashkimit Evropian;
34. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
35. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
36. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
37. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet;
38. {...}- ka përvojë profesionale më pak se 10 vjet.

Këto ishin dy listat e kandidatëve që nuk pranohen për t'u futur në provimin e pranimit për Ndihmësit dhe Këshilltarët Ligjorë.

Ndërsa vendimit, siç e paraqita që në fillim, i bashkëlidhen gjithashtu, përveç këtyre dy listave edhe listat e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin

e formimit për vitin akademik 2019-2020. Faleminderit!

(Zoti Muharremaj merr sërish fjalën për të lexuar edhe listën e kandidatëve të kualifikuar.)

Atëherë po vijoj me lidhjen nr. 1 e cila përmban listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për Ndihmës Ligjorë:

1. {...};
2. {...};
3. {...};
4. {...};
5. {...};
6. {...};
7. {...};
8. {...};
9. {...};
10. {...};
11. {...};
12. {...};
13. {...};
14. {...};
15. {...};
16. {...};
17. {...};
18. {...};
19. {...};
20. {...};
21. {...};
22. {...};
23. {...};
24. {...};
25. {...};

26. {...};
27. {...};
28. {...};
29. {...};
30. {...};
31. {...};
32. {...};
33. {...};
34. {...};
35. {...};
36. {...};
37. {...};
38. {...};
39. {...};
40. {...};
41. {...};
42. {...};
43. {...};
44. {...};
45. {...};
46. {...};
47. {...};
48. {...};
49. {...};
50. {...};
51. {...};
52. {...};
53. {...};
54. {...};
55. {...};

56. {...};
57. {...};
58. {...};
59. {...};
60. {...};
61. {...};
62. {...};
63. {...};
64. {...};
65. {...};
66. {...};
67. {...};
68. {...};
69. {...};
70. {...};
71. {...};
72. {...};
73. {...};
74. {...};
75. {...};
76. {...};
77. {...};
78. {...};
79. {...};
80. {...};
81. {...};
82. {...};
83. {...};
84. {...};
85. {...};

86. {...};
87. {...};
88. {...};
89. {...};
90. {...};
91. {...};
92. {...};
93. {...}.

Ndërsa, lidhja 3, gjithashtu pjesë e vendimit, përmban listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për Këshilltarë Ligjorë, dhe përbëhet nga:

1. {...};
2. {...};
3. {...};
4. {...};
5. {...};
6. {...};
7. {...};
8. {...};
9. {...};
10. {...};
11. {...};
12. {...};
13. {...};
14. {...};
15. {...}, {...}, më falni;
16. {...}.

Këto janë edhe listat e kandidatëve që kualifikohen për të marrë pjesë në provimin e formimit për vitin akademik 2019-2020, për Ndihmës dhe Këshilltarë Ligjorë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim?

Brikena Ukperaj: Për lehtësi të punës edhe për anëtarët e tjerë të Këshillit, ne kemi përgatitur edhe tabelat përkatëse me të gjitha, duke i specifikuar në kolona të veçanta të gjitha kriteret e veçanta dhe të përgjithshme që janë të parashikuara në ligj ku dhe evidentohen problemet/problematikat që janë shfaqur në evidentimin e plotësimit të kriterëve.

Naureda Llagami: Ka ndonjë pyetje? Paqartësi?

Atëherë, do ta kalojmë në votim? E hedhim në votim?

Atëherë, hedhim në votim projektvendimin e propozuar nga Komisioni përkatës.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, projektvendimi u miratua sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 12.03.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.12, datë 18.01.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:18 dhe mbaroi në orën 15:06.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Medi Bici | (anëtar) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*

RENDI I DITËS:

2. Miratimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.12, datë 18.01.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës.

Atëherë, më lejoni, edhe për shkak të kërkesës së një nga kolegeve tona, lidhur me transparencën sa i përket procesit të hartimit të strukturës, më lejoni t’ju kujtoj çfarë veprimesh ka bërë Këshilli deri tani.

Ju sjell në vëmendje që më 18 janar të 2019-ës, Këshilli në mbledhjen e parashikuar në atë datë, ka miratuar strukturën me 144 punonjës, duke propozuar edhe një lloj ristrukturimi të këtyre punonjësve. Më pas, nga ana e administratës së Këshillit është dërguar një shkresë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë më datë 24 janar të 2019-ës, me nr. prot. 371, në bazë të së cilës i është kërkuar që (po e lexoj tekstualisht shkresën, për ato që nuk e kanë dijeni – shkresa është në protokoll):

“Duke shpresuar konsideratën për veprimtarinë e Kuvendit të Republikës si dhe të Komisionit që ju drejtoni, siç jeni në dijeni, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në vijim të ushtrimit të veprimtarisë, mbështetur në ligjin “Për organet e qeverisjes gjyqësore”, miratoi vendimin nr. 12, datë 18.01.2019, strukturën organizative të funksionimit të tij. Sa më sipër, bazuar në parashikimet e ligjit për buxhetin të 2019-ës, ju lutem miratimin nga ana juaj të numrit të përgjithshëm të punonjësve sipas strukturës organizative të miratuar nga Këshilli, si dhe buxhetin përkatës sipas materialit bashkëlidhur kësaj

shkrese”.

Po të shohim materialet bashkëlidhur kësaj shkrese - që ju mund të keni një fotokopje shumë shpejt - në materialet bashkëlidhur është vendimi i Këshillit lidhur me strukturën organizative, janë përlogaritjet që janë bërë nga departamenti jonë i financës dhe njëkohësisht edhe buxheti në total. Gjithashtu, këto lloj aktesh, ashtu sikurse ju kam vënë në dijeni, janë publikuar edhe në faqen zyrtare të Kuvendit në momentin që e nisëm shkresën, ndërkohë që unë kam hezituuar ta publikoj në faqen tonë zyrtare për efektin e vetëm sepse doja, njëherë që kjo lloj strukturë të ishte finale/përfundimtare, që ne mund ta publikonim.

Çfarë ndodhi gjatë procesit të vendimmarrjes në Kuvend?

Kemi pasur konsulta me kryetarin e Komisionit të Ligjeve. Na ka thërritur kryetari i Komisionit të Ligjeve për diskutimin se si do të procedonin për miratimin e strukturës dhe në atë moment, sikurse është bërë e ditur edhe gjatë seancës dëgjimore, vetë Komisioni i Ligjeve fillimisht mendonte që do na miratonte një strukturë, më pas, pas shumë debateve u arrit në konkluzionin që do miratohej një numër i përgjithshëm i punonjësve, pavarësisht që ky numër... dhe strukturimi na u la detyrë dhe po t'i referoheni edhe procesverbalit të Kuvendit, të Komisionit të Ligjeve të datës 19.02.2019, relatori i çështjes, bashkë me kryetarin e Komisionit të Ligjeve na e la detyrë që të rakordonim, lidhur me strukturën dhe kategorizimin e pagave, me Departamentin e Administratës Publike.

Lidhur me shqetësimin që kishit për sa i përket opinionit të EURALIUS-it, ju sjell në vëmendje që opinionin e EURALIUS-it, sikurse e kam bërë edhe me dije në mbledhjen e mëparshme, ndoshta jo me mikrofon, por pa mikrofon, opinionin e EURALIUS-it është depozituar përmes postës elektronike pranë Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, 20 minuta përpara se të futeshim në mbledhjen e datës 18.01.2019, dhe në versionin anglisht. Për këtë arsye unë nuk mund ta pranoja një opinion të tillë 20 minuta përpara vendimmarrjes tonë. Ky lloj opinionin e është dërguar edhe Kuvendit dhe lidhur me qasjen ndaj këtij opinionin, edhe Kuvendi, relatori i strukturës tonë, ka pasur komentet e veta në mënyrën se si ky relacion është hartuar. Për më shumë detaje mund të klikoni në uebsajtin (*website-in*) e Kuvendit dhe të merrni procesverbalin lidhur me transparencën.

Pavarësisht se jua kam bërë ftesën gjithsecilit nga ju që të vinte mua atë ditë në Kuvend, por asnjëri nga ju nuk pranoi që të vinte në Kuvend. I vetmi që më erdhi në Kuvend ishte Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Pasi mbaruam dhe u miratua vendimi i Kuvendit lidhur me numrin e përgjithshëm të strukturës, një nga detyrimet që na ka dhënë vendimi, është që të miratohet një VKM, e cila do lidhet me kategorizimin e pagave dhe për kategorizimin e pagave bëhet shuma totale e buxhetit, për të cilën do bëhet alokimi tek Ministria e Financave sepse fondi jonë është ende i bllokuar.

Në këtë këndvështrim filloi puna rakorduese me Departamentin e Administratës Publike, i cili është autoriteti përkatës që bën kategorizimin e pagave për administratën e Këshillit. Sikurse jeni në dijeni, mënyrat e punësimit të Këshillit janë dy, janë përmes statusit (që bëhet fjalë për ato që janë magjistratë), janë edhe me nëpunësin civil (për të gjithë pjesën tjetër). Në këtë këndvështrim, unë kam bërë takime personale, kemi punuar gjatë gjithë këtyre ditëve në rakordim me Departamentin e Administratës Publike dhe si rezultat kemi hartuar një draft strukturë, duke mbajtur parasysh edhe kërkesat që ju kishit gjatë strukturës së parë dhe duke reflektuar, duke akomoduar të gjithë nevojat tuaja dhe ia kam çuar atë Departamentit (*DAP-it*), i cili nuk është draft final, por Departamenti (*DAP-i*) e kërkonte këtë gjë për të kategorizuar pagat. Në këtë këndvështrim, ju sjell në vëmendje që shkresa me datë 04.03.2019, po të lexojmë edhe përmbajtjen e shkresës, atë që unë i referoj Departamentit (*DAP-it*) është draft struktura e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me relacionin përkatës, që do të thotë që nuk është një strukturë përfundimtare sepse atë do ta miratojmë ne sot këtu.

Pra të gjithë ato situata që ‘kemi qenë në padijeni’, mua boll të më vinit dhe të më kërkonit informacione, unë jam munduar të jem shumë e hapur me gjithsecilin prej jush edhe për strukturën, duke ju ftuar hajde të diskutojmë. E keni vlerësuar që kjo pjesë nuk ju ka interesuar shumë. Ky është një produkt grupi i cili është bërë nga administrata e Këshillit dhe unë jam ai personi që e drejton administratën dhe kam përgjegjësi për të gjithë stafin e administratës dhe për atë që vepron Kryetari në cilësinë e marrëdhënies me të tretët.

Kalojmë tek struktura e propozuar. Ajo strukturë që unë ju propozoj sot, në thelb

është e njëjta strukturë të cilën unë ju kam propozuar.

(Zonja Kadi ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Naureda Llagami: Më fal! Mund ta mbaroj unë fjalimin dhe pastaj do flasësh ti.

Brunilda Kadi: Pse është me urdhërim, që s'mund të marrë fjalën?

Naureda Llagami: Nuk mund të ndërpresësh fjalën time tani, kur unë s'e kam mbaruar.

Brunilda Kadi: Kërkova fjalën. Mirë që nuk e hodhët në votim miratimin e rendit të ditës, sepse unë ngrita një shqetësim dhe duhet të kishit pyetur, sepse që aty u shkel procedura e mbledhjes. Duhet ta kishit hedhur në votim miratimin e rendit të ditës. Nuk e bëtë. Tani, folët, sqaruat, dua të sqaroj edhe unë sepse kishte shumë gjëra që për mua nuk janë të vërteta ose korrekte.

Naureda Llagami: Ke shumë të drejtë edhe unë do ta jap fjalën në momentin që unë mbaroj relatimin e projekt-aktit. Jeni të gjithë të hapur të bëni komentet dhe diskutimet tuaja.

Atëherë, struktura që ju kam propozuar është një strukturë e cila në kuptimin e funksionalitetit të Këshillit është menduar dhe është konceptuar të ruhet e njëjta strukturë siç ka qenë tek drafti i propozuar dhe i miratuar prej jush më 18 janar, që do të thotë që numri i njësisë së Këshilltarëve Ligjorë që do asistojë anëtarët e Këshillit, Komisionet e Përhershme, është ruajtur i njëjtë. Numri i njësisë që do merret me vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve është ruajtur i njëjtë. Është zvogëluar kabineti i Kryetares dhe nga ana tjetër edhe departamentet kryesore janë lënë të njëjtë për sa i përket rëndësisë që kanë departamentet. Nuk kemi shkrirje departamentesh kryesore. E vetmja, një drejtori që kemi pasur lidhur me marrëdhëniet me publikun, është vënë brenda Departamentit për Shërbimin Juridik dhe Marrëdhëniet me Publikun. Pra në thelb, funksionaliteti i Këshillit nuk është prekur nga vendimmarrja jonë e parë.

Sikurse jeni në dijeni, numri që na ka miratuar Kuvendi është 125. Në diskutime me DAP-in, DAP-i, pasi ne miratojmë këtë, na ka dhënë propozimet për kategorizimin e pagave, ku ne jemi në koordinim me ato, dhe ne, pasi miratojmë edhe këtë strukturën, DAP-i i dërgon Këshillit të Ministrave ndryshimin e VKM-së mbi kategorizimin e pagave dhe në këtë mënyrë ne na lejohet edhe aksesimi i buxhetit që Këshilli duhet të

bëjë. Kaq kisha lidhur me propozimin e projekt-aktit. Ndërkohë, çështja është shumë e hapur për diskutime.

Brunilda Kadi: Të jetë e hapur, s'ka nevojë të jetë shumë e hapur çështja.

E para, përpara se të kaloj tek struktura konkrete, në radhë të parë, ne ligjin e lexojmë të gjithë dhe të gjithë e dimë që Kuvendi i Shqipërisë nuk merret me strukturën e brendshme të një organi të ri kushtetues, miraton vetëm numrin e përgjithshëm në total të punonjësve dhe përfaqësuesit e atij institucioni të ri shkojnë në Kuvend dhe prezantojnë një strukturë për të justifikuar pse e kërkojnë këtë numër, por jo se Kuvendi hyn në meritat e asaj strukture. Ai miraton një numër të përgjithshëm sipas vlerësimit të Kuvendit (se ia ka dhënë Kushtetuta këtë të drejtë).

Për sa i përket EURALIUS-it, që ishte në gjuhën angleze, domethënë justifikime pa lidhje, deri sot, besoj se duhej të ishte përkthyer ose të na ishte sjellë ose të gjithë këto komunikime që janë bërë me Kuvendin, unë mendoj që nuk janë personale të Kryetares, por duhet të jenë në dispozicion të gjithë anëtarëve të Këshillit. Kur ju thoni që keni qenë e hapur për të ardhur për të folur me juve personalisht, unë mendoj që kjo është një çështje ligji, nuk është një çështje personale. Ne po flasim për ligjin këtu. Ju keni detyrimin, se siç e cituat edhe vet, jeni përgjegjëse për administratën, jeni përgjegjëse pra, edhe ndaj anëtarëve jeni përgjegjëse, pra keni përgjegjësi, jo të drejta, që t'iu bëni të mundur të gjithë informacionin e mundshëm që anëtarët, bashkë me juve, të marrin një vendim të bazuar në ligj dhe në akte, që duhet t'i kenë paraprakisht, jo që i keni juve dhe menduat që mund të botoheshin në faqen zyrtare të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Tani, këtu, tek kjo shkresa që juve cituat, i keni nisur Departamentit të Administratës Publike, që unë nuk e kuptova nga shpjegimi juaj, ju kanë dhënë ata një mendim, a jeni në këtë periudhën tranzitore që jepni dhe merrni mendim, unë nuk e kuptova, por gjithsesi, unë nisem nga teksti i shkresës që i keni dërguar dhe thoni 'draft struktura e Këshillit të Lartë Gjyqësor' dhe unë e bëra pyetje që në fillim, -Kush e ka miratuar këtë draft? –Juve me administratën? Sepse kur ne miratuam strukturën në datën 18 janar, kemi diskutuar me orë të tëra të gjithë bashkë, i kemi marrë të gjithë ato elementet e strukturës dhe kemi arritur në atë konkluzion që arritëm. Tani, Kuvendi tha, - "Jo 144, do keni 125". Se si do t'i ndani këto është kompetencë kushtetuese e këtij

Këshilli dhe këtë e bën Këshilli, e nderuar Kryetare, nuk e bëni ju me administratën. Unë nuk e di se si merret gjithë ky guxim, shkruhet në letër që juve i nisni Departamentit (*DAP-it*) draft strukturën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në emrin tuaj. Unë nuk e kuptoj këtë guxim?! Më duket i tepruar.

Meqenëse e mora fjalën, tani edhe sa i përket meritës së strukturës, është e vërtetë që ne e kemi miratuar strukturën, pak a shumë, ju thatë që keni hequr, nuk e di çfarë keni hequr këtu (ca gjëra teknike), por gjatë kësaj kohe, mbas miratimit, sepse njeriu lexon, dëgjon argumentat edhe e përmirëson vendimmarrjen e tij, siç edhe e kam diskutuar jashtë kësaj seance, unë nuk kam mundur të gjejë një shembull, jashtë dhe brenda Shqipërisë, se ku Kryetari i një organi kolegjal ka kabinet. Nuk e kam gjetur. Dhe ky ishte edhe një nga sugjerimet e Misionit EURALIUS, që Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk duhet të ketë kabinet sepse ai është si gjithë anëtarët e tjerë. E vetmja kompetencë që ai ka, ndryshe nga anëtarët e tjerë është që të përfaqësojë Këshillin me të tretët, që do të thotë, ndryshe nga anëtarët, i takon të ketë një sekretare në paradhomë dhe ndoshta një këshilltar për marrëdhëniet me publikun. Nëse ju keni kabinet, atëherë të gjithë anëtarët duhet të kenë kabinet sepse kjo bën një diferencë antikushetuese. Ligji thotë që ne jemi organ kolegjal. Ju lutem, më gjeni bazën ligjore, më gjeni një shembull të një organi kolegjal ku Kryetari ka kabinet. Dhe nuk kemi pse të ikim shumë larg. Neve, vetëm para 1 viti e gjysmë ose gati 2 vjetësh, u krijuan dhe u ndërtuan dy nga organet kryesore të sistemit të drejtësisë që janë Këshilli i Posaçëm i Apelit dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, që të dy, Kryetarët nuk kanë kabinet. Janë organe kolegji. Dhe analogji më të pastër se sa kjo, unë nuk besoj se mund të gjejmë. Unë nuk e di se si anëtarët e tjerë do votojnë pro kësaj strukture sepse mendoj që është e kundërligjshme. Faleminderit!

Naureda Llagami: Thjesht për të sqaruar, zonja Kadi!

Për sa i përket propozimit të strukturës, mua më vjen keq se është e disata herë e përsëritur me juve që keni vendimmarrje dhe ndryshoni vendimmarrjen tuaj dhe kjo nuk është fare etike për një natyrë si puna juaj që jeni edhe gjyqtare, që rishikoni gjithmonë vendimet që merrni, nuk jeni dakord me ato që i vendosni dhe i merrni vet. Kjo në fakt nuk është shumë e mirë për punën e Këshillit sepse nuk tregon qëndrueshmëri dhe

konsolidim në atë që ne shprehim me vendim. Këtë vërejtje mund ta kishe bërë që në miratimin e strukturës së parë sepse unë nuk kam bërë ndonjë ndryshim të madh, përveçse kam ulur numrin e këshilltarëve.

Lidhur me kabinetin edhe për analogji, po ju marr më lart KLP-në e cila e miratoi kabinetin e saj dhe jo më larg se para tre ditësh kabineti i saj ishte edhe më i madh sesa kam unë, në kuptimin e kompetencave që ka KLP-ja.

(Zonja Kadi ndërhyr pa ndezur mikrofonin.)

Më fal! Ta mbaroj deri në fund. Mos më ndërpre!

Brunilda Kadi: Nuk është miratuar KLP-ja. Nuk është miratuar. Korrigjoje!

Naureda Llagami: Të lutem! Është miratuar sepse kam lëshuar mbledhjen këtu dhe e kanë kaluar me mbledhje. Të lutem!

(Zonja Kadi flet pa ndezur mikrofonin.)

Brunilda Kadi: Nuk është miratim zonja Kryetare. Duhet ta certifikojë DAP-i dhe Ministria e Financës.

Naureda Llagami: Të lutem, edhe një herë! Mos më ndërpre kur unë flas sepse unë të respektoj kur ti flet. Minimumi kaq etikë ne duhet ta kemi midis njëri-tjetrit, se je edhe gjyqtare.

Atëherë, KLP-ja ka mbajtur të njëjtën qasje. Ka bërë një kabinet lidhur me pjesën e kryetarit, për shkak të kompetencave që ka kryetari.

Lidhur me pjesën për sa i përket mendimit të EURALIUS-it, unë në e-mailin tim, po nga eksperti i EURALIUS-it kam dy variante të ndryshme, një variant të sjellë në anglisht, një variant tjetër të sjellë po në anglisht të thënë ndryshe. Pra ky është edhe vendimi zyrtar që EURALIUS-i ia çoi edhe Kuvendit, nëse ai do konsiderohet, zoti Maksi që ishte me mua prezent atje, u bënë komente të caktuara lidhur me mënyrën e ligjshmërisë së atij propozimi të dhënë nga EURALIUS-i. Prandaj, unë nuk kam më diskutime.

Lidhur me pjesën që çfarë gjykoj unë për pjesën e strukturës, po ta shohësh, unë jam treguar shumë e kujdesshme edhe me DAP-in, nuk kam thënë që është strukturë sepse atë do e them në momentin që neve e miratojmë. Unë kam thënë që është një draft strukturë. Unë me të gjithë diskutimet tuaja formale, kam marrë parasysh nevojat dhe kjo

është detyra ime, të akomodojë dhe të adresojë sa më mirë funksionalitetin dhe menaxhimin e Këshillit. Kjo është detyra e Kryetarit.

Kështu që, lidhur me pjesën ku secili prej jush mund të ketë paqartësi, dera e Kryetarit është shumë e hapur për t'ju dhënë paqartësitë dhe për t'i dhënë shpjegim të gjithë gjërave. Kështu që unë nuk e gjykoj fare të arsyeshme ato që ju thatë.

Atëherë, kemi diskutime të tjera?

Ta kalojmë për votim?

Brunilda Kadi: Dua të bëj një propozim. Propozoj që tek numrat 1+6 tek Kabineti, e para njëherë, të mos ketë termin 'Kabinet'. Kryetari mund të ketë një sekretar, një mbështetës siç do kenë edhe gjithë anëtarët e tjerë dhe një këshilltar, që do të thotë 1+2 dhe ato që teprojnë (4) t'i kalojnë Njësisë së Vlerësimit Profesional dhe Etik ose edhe Komisionit që merret me rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve, sepse siç e dimë nga përvoja, ne gjyqtarët e dimë që vlerësimi profesional dhe ai i rivlerësimit është një proces voluminoz dhe kërkon shumë kapacitete njerëzore. Ky është propozimi im. Mund ta hidhni në votë. Le të rrëzohet.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votë lidhur me propozimin për strukturën, pra me 125 punonjës, të prezantuar sipas modelit që keni bashkëlidhur.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Kryetare, në fillim hidhet në votim ajo që propozohet ndryshe, megjithatë është e drejta juaj. Unë jam kundër kësaj strukture.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projektvendimi "Për një ndryshim në vendimin nr.12, datë

18.01.2019, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë sipas skemës bashkëlidhur këtij vendimi.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 12.03.2019)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i projektvendimit “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:18 dhe mbaroi në orën 15:06.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*

RENDI I DITËS:

3. Miratimi i projektvendimit “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e tretë e rendit të ditës.

Çështja e tretë e rendit të ditës është: Miratimi i projektvendimit “Për korrigjimin e gabimit në shkrim në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Lidhur me miratimin e këtij projekt-akti po ia jap fjalën kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, zotit Ilir Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Atëherë, ky projekt-akt u vu menjëherë në lëvizje për shkak se me vendimin nr. 35, datë 19 shkurt 2019 “Për caktimin e gjyqtareve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”, na ka mbërritur një shkresë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat e cila është protokolluar vetëm ditën e djeshme, është referuar që ka një gabim në shkrim në lidhje me identifikimin e një çështjeje penale, është bërë gabim në emrin e të pandehuri. Që të evadohet çështja, për të mos krijuar pengesa, konsideruam që të hyjë menjëherë në rendin e ditës dhe të bëhet korrigjimi i vendimit të zbardhur, sa i përket Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe pikërisht pikës 5, ku është caktuar gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, zonja {...}, në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Rrethit

Gjyqësor Mat; i pandehur: {...} (ndërsa është shkruar gabimisht emri i një të pandehuri tjetër), dhe është identifikuar edhe akuza në ngarkim të të pandehurit {...}. Është përgatitur edhe projektvendimi për këtë dhe ky projektvendim gjen bazë ligjore në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative. Ftoj anëtarët/kolegët që ta miratojnë këtë projektvendim.

Naureda Llagami: Ndonjë diskutim, koment?

Atëherë, e hedhim në votim projektvendimin sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli miratoi vendimin për korrigjimin e gabimit në shkrim në vendimin nr. 35, datë 19.02.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në të cilën vendosi: 1. Korrigjimin e gabimit në shkrim, në paragrafin I, nënndarja “Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat”, pika 5, të vendimit nr. 35, datë 19.02.2019, “Për caktimin e gjyqtareve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta, në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionin në mënyrë të përhershme”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: “5. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, {...}, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, çështjen penale me kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Mat; të pandehur: {...}; i akuzuar për veprat penale “Shkatërrim prone”, “Kanosje për shkak të detyrës” dhe “Prishje e qetësisë publike”, parashikuar nga nenet 150, 238 dhe 274 të Kodit Penal”; 2. Një kopje e

vendimit t'i njoftohet gjyqtares {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 12.03.2019)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Miratimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm” lidhur me gjyqtarin {...}.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:18 dhe mbaroi në orën 15:06.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Medi Bici*** (anëtar)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Illir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)
11. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 4. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 5. Përfaqësues të EURALIUS-it.*

RENDI I DITËS:

4. Miratimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm” lidhur me gjyqtarin {...}.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e katërt e rendit të ditës, që është: Miratimi i projektvendimit “Për deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm” lidhur me gjyqtarin {...}.

Lidhur me propozimin e këtij projekt-akti, i jap fjalën zotit Ilir Toska, në cilësinë e kryetarit të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Ilir Toska: Faleminderit!

Edhe ky projekt-akt është sjellë me urgjencë në Këshill për shkak të situatës së krijuar vetëm ditën e djeshme. Gjyqtari {...} është gjyqtar i caktuar në mënyrë të përhershme në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë, ndërsa me vendim të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë të datës 13 qershor 2018, me nr. 47, ai është transferuar në mënyrë të përkohshme për 1 vit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës.

Ndërkohë, në ditën e djeshme, nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është vendosur shkarkimi nga detyra e kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë dhe tashmë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tropojë ka ngelur vetëm me dy gjyqtarë. Një gjyqtar është gjyqtari {...}, i cili është i transferuar në mënyrë të përkohshme pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Në këto kushte, për mos cenimin e funksionalitetit të

kësaj gjykate, por edhe për faktin se gjyqtari {...} vetëm në datën 6 mars 2019 është zgjedhur nga mbledhja e asaj gjykate në cilësinë e zëvendëskryetarit, pra është ai që do duhet të ushtrojë tashmë në mungesë të kryetarit, funksionet e kryetarit të asaj gjykate. Kemi propozuar që të deklarojmë përfundimin e periudhës së transferimit të përkohshëm për gjyqtarin {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës dhe kthimin e tij në pozicionin e mëparshëm, pra në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Ky vendim, kemi referuar që t'i fillojë efektet ditën e nesërme, pra në datën 13 mars 2019. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kemi diskutime?

E hedhim për votim projekt-aktin sipas propozimit të bërë nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Illir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi miratimin e vendimit për deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm, sipas kësaj përmbajtjeje: Deklarimin e përfundimit të periudhës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kukës, sipas vendimit nr. 47, datë 13.06.2018, të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kthimin e gjyqtarit {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tropojë. Një kopje e vendimit t'i njoftohet gjyqtarit {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 13.03.2019.

Marçela Shehu: Lidhur me thirrjen drejtuar gjyqtarëve për të aplikuar në skemën e delegimit. Në disa mbledhje ne kemi diskutuar që duhet të bëhet publike njoftimi në faqen zyrtare të Këshillit sepse rregullorja që kemi miratuar, ne kemi rënë dakord që është e përkohshme, jo të zgjasë për shumë kohë, ndaj një thirrje e re drejtuar të gjithë gjyqtarëve, do të ishte për mua efiçente.

Naureda Llagami: Ke shumë të drejtë. Ndoshta është gabim i stafit i cili nuk e ka reflektuar këtë sugjerim, që ta mbajë në kontakt të përhershëm thirrjen.

Ne kemi pak probleme me uebsajtin (*website-in*), për të cilën po mendojmë të transferohemi tek uebsajti (*website-i*) i ri. Kjo është edhe arsyeja që nuk e kemi hedhur procesverbalin audio. Me publikimin e uebsajtit (*website-it*) të ri, i gjithë informacioni do hidhet në atë uebsajt (*website*) dhe do të përditësohet në kohë reale. I tërheq vëmendje stafit që të vazhdojë me publikimin e njoftimit që ne thamë që duhet ta kemi tek uebsajti (*website-i*) non stop lidhur me aplikimin për skemën e delegimit.

Ndonjë gjë tjetër?

Brunilda Kadi: Meqenëse referuat tek pjesa teknike e uebsajtit (*website-it*), pra çështje teknike që procesverbalet në fletë publikohet dhe çdo vendim i joni publikohet, ndërsa audiot nuk u publikuakan? Është çështje teknike? Po të jetë kështu, mos t'ia ngarkojmë këtë përgjegjësi administratës që nuk e bën. Në fakt kjo është përgjegjësia juaj si Kryetare, se këtë e keni një nga përgjegjësitë, të kujdeseni për mbledhjet dhe për transparencën. Kjo është arsyeja që nuk janë hedhur audiot? Se morët përsipër të sqaronit të gjitha shqetësimet, për këtë nuk thatë asnjë gjë Kryetare. Ta kemi të qartë. Në qoftë se është teknike.

Naureda Llagami: Është edhe teknike sepse në uebsajtin (*website-in*) që ne kemi, nuk kemi shumë hapësirë që ne të hedhim shumë dosje sepse është konceptuar i këtillë uebsajti (*website-i*). Në momentin që neve do fillojmë të translojmë tek uebsajti (*website-i*) tjetër, do ketë një vend të dedikuar ku do hidhet sistemi audio, siç vepron edhe KLP-ja. Në këtë situatë që jemi, po veprojmë në këtë lloj mënyre, por kjo s'është thotë që me të kaluar tek uebsajti (*website-i*) i ri edhe audiot gjatë kësaj kohe do pasqyrohen aty.

Ndonjë gjë tjetër?

Okej! Faleminderit! Ditë të mbarë!

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor